

2639



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
SEKTORI I TURIZMIT, ARSIMIT, KULTURËS, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2639 Prot.

Klos, më 26.09.2023

Lënda: Dërgim projekt- vendimi për miratim.

Drejtuar: KËSHILLIT TË BASHKISË KLOS

Bashkëlidhur gjeni projekt-vendimin “Për marrje ambjenti privat me qera për kopshtin e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Haxhi Lata” Suç”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË
Valbona KOLA



Konc.& Prin.: D. Gjini [Signature]
Pranoi: I. Kodra [Signature]
Verif&Konf: A. Laçi
Kopj: 3(tre)
Datë: ____ .09.2023 [Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
SEKTORI I TURIZMIT, ARSIMIT, KULTURËS, SPORTIT DHE RINISË

Nr. ____ Prot.

Klos, më ____ . ____ .2023

PROJEKT – VENDIM
PËR
“MARRJE AMBJENTI PRIVAT ME QERA PËR KOPSHTIN E SHKOLLËS SË
MESME TË BASHKUAR “HAXHI LATA” SUÇ”

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” neni 54 pika “n” “Detyrat dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak”, në Ligjin Nr. 69/2012 datë 21.06.2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshua, si dhe bazuar në Akt-Ekspertizën e datës 29.06.2020 të Institutit të Ndërtimit Tiran, për problematikën strukturore të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Haxhi Lata” Suç, rezulton që shkolla është jo funksionale për shkak të dëmtimeve të marra nga tërmeti, i propozojmë Këshillit të Bashkisë të marri në shqyrtim dhe të vendosi si më poshtë vijon.

1. Për marrje ambjenti privat me qera (tre dhoma) për kopshtin e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Haxhi Lata” Suç, sipërfaqja e të cilit është 80 m².
2. Çmimi i dhënies me qera të jetë 5000 (pesë mijë) lekë për dhomë në muaj.
3. Kontrata të lidhet me afat 1 (një) vjeçar (vit shkollor) me të drejtë rinovimi.
4. Efekti financiar fillon me 01.09.2023 deri me 30.06.2024.

P/ SEKTORIT TË ARSIMIT
Ishe KODRA

NËNKRYETARI I BASHKISË
Adelina LAÇI

KRYETARI I BASHKISË
Valbona KOLLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
SEKTORI I TURIZMIT, ARSIMIT, KULTURËS, SPORTIT DHE RINISË

RELACION

PËR

**“MARRJE AMBJENTI PRIVAT ME QERA PËR KOPSHTIN E SHKOLLËS SË
MESME TË BASHKUAR “HAXHI LATA” SUÇ”**

Shkolla e Mesme e Bashkuar “Haxhi Lata” Suç është nën juridiksionin e Bashkisë Klos. Për shkak të tërmetit, nëntor 2019, rezulton jo funksionale për zhvillimin e procesin mësimor. Nisur nga ky fakt, për sistemimin e dy grupeve të kopshtit të kësaj shkolle dhe të një klase fillore, mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” neni 54 Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak, Ligjin Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshua dhe në Akt-Ekspertizën e datës 29.06.2020 të Institutit të Ndërtimit Tiranë, për problematikën strukturore të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Haxhi Lata” Suç, Bashkia Klos ka marrë ambjente private me qera. I kërkojmë Këshillit të Bashkisë që të miratojë pagesën për këtë ambjent privat me qera si më poshtë :